



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-klina.org

ZYRA E PROKURIMIT

01 NR 642-6940/18

Me 23.10.2018

KONTRATA , KUSHTET SPECIALE & ANEKSET E NDËRLIDHURA

PJESA I : KONTRATA PUBLIKE KORNIZE

NR. 090/2018

Komuna Kline , (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), Nr .Regjistrir 07000032 dhe Nr. Fiskal 600219366 ,qe perfaqesohet nga Z.Abaz Foniqi –menagjer i z. Prokurimit në njërën anë;

dhe

AS TRADE SHPK “ (në vazhdim “Operatori Ekonomik”) KLINE me numer biznesi – 71290808 nr. Fiskal 601647417 qe perfaqesohet nga drejtori z. FATOS DRESHAJ

.Ne anën tjetër, janë pajtuar te lidhin një kontrate publike për:

FURNIZIM ME RADIOLIDHJE DHE PAISJE TJERA

PER ZHBZ

me numër Identifikues 634-18-7007-131/634-18-070-136

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë kontrate publike KORNIZE

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë dërgesa., nga Furnizuesi, i furnizimeve në vijim:

1.2

Nr. i Artikul	Përshkrimi	Njësia	Sasia	Çmimi njesi DDP ¹ - €	Çmimi total €
1	RADIO LIDHJE DORE NE LARG KOMUNIKIMI 5 DERI 7 KM –marresi dhe dhenes	komplet	16	170.00	2.720.00
2	POMPA SHPINE PER SPERKATJE ME BAT ME KAPACITET 20 LITERSHE	COPE	10	100.00	1.000.00
3	BATERI DORE 50 VAT ME ADAPTER HIGHIGHT.	cope	16	25.00	400.00

¹ Detyrimi i Dorëzimit është Paguar - Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare.

4	LLAMPA AKOMOLUESE EMERGJENTE PA LLAMP	cope	4	70.00	280.00
5	POQA ELEKTRIKE TE NEONIT 20 w	cope	50	4.00	200.00
6	FOTO APARAT KAMER POWERSHOT A 40 2 M	cope	1	230.00	230.00
7	Bateri per pomp te shpines Per artikullin nr.2	COPE	10	25.00	250.00
8	Bateri per Radiolidhje nga Pozicini i Artikullit 1	Cope	10	10.00	100.00
9	Bateri per Aparat nga Artikullin ne Poz. 6	Cope	10	30.00	300.00
10	Syra - drite per bateri te dores nga Artikulli pozicionin 3	cope	20	15.00	300.00
Totali i Përgjithshëm:					

Neni 2 Kushtet e dërgesës

2.1 Afati kohor për dorëzim do të jetë JO ME SHUME SE 30 DITE NGA MARRJA E POROSIS .

2.2. Produktet duhet te jene te kualiteit sipas ofertes se dhene .

2.3. Kontrata hyne n fuqi me date 21.10.2018 .

2.4 Vendi i dorëzimit të furnizimit do të jetë KLINE.Sipas Urdhereses se Drejtorise se SH.P. DHE EMERGJENTE

2.4 Inkotermi² i zbatueshëm do të jetët *DDP Kline*

Neni 3 Origjina

3.1 Furnizuesi duhet të dorëzojë një certifikatë të origjinës së furnizimeve, më së voni atëherë kur e kërkon pranimin e përkohshëm të furnizimeve. Mosveprimi sipas këtij kushti mund të ketë si rezultat ndërprerjen e kontratës.- edhene ne Specifikacioni Teknik te Dorzuar me oferte qe eshte pjese integrale e kësaj kontrate .

3.2 Origjina e mallrave do të përcaktohet sipas Kodit të Doganave të Bashkësisë Evropiane (Community Customs Code-) ose sipas marrëveshjeve ndërkombëtare të cilat i ka nënshkruar vendi në fjalë.

Neni 4 Çmimi

4.1 Çmimi total i furnizimeve duhet të jetë: **5.780.00€;**

(Pesemijeshateqindetetedhjeteuro)

² Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

4.2 Çmimi i përmendur në Nenin 4.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Furnizuesit sipas kontratës.

4.3 Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

4.4 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

Neni 5

Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

5.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Kjo marrëveshje e kontratës;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Furnizuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
- (e) Deklaraten e Konfirmimit;
- (f) Deklaraten e Garancise se produktit 12 muj nga Data e liferimit
- (g) Standardet ISO 9001-2015 14001-2015 për vlerësim të Kompanisë
- (h) Oferta financiare;

5.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 6 Komunikimet

6.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Furnizuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

6.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimi të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimi të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

6.3 Kudo që në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të shenohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

6.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën SHQIPE ^{3]} në kater origjinale, tri prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Furnizuesin.

Për Autoritetin Kontraktues

Kontraktuesi:	KOMUNA KLINE	Për Furnizuesin	AS TRADE –SHPK
Emri:	ABAZ FONIQI	Emri:	KLINE
Pozita:	Zyrtar përgjegjës i prokurimit	Pozita:	FATOS DRESHAJ
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	23.10.2018	Data:	23.10.2018
Vula:		Vula:	

³ Gjuha do të jetë gjuha e shfrytëzuar nga tenderuesit në këtë tender.